

Emri i Lëndës : Sjellje Organizative							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
CMP 507	A	Vjeshtë	3.00	1.00	0.00	3.50	6.00
Lektori		Ana Uka, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Sjellja organizative ka të bëjë me studimin e sjelljes njerëzore në punë. Ajo është fusha e studimit që hulumton ndikimin që kanë individët, grupet dhe strukturat mbi sjelljen brenda organizatës. Sjellja organizative është studimi dhe zbatimi i njohurive për mënyrën se si veprojnë punonjësit brenda organizatës. Si fushë, ajo zbatohet gjerësisht në sjelljen e punonjësve në të gjitha llojet e organizatave, si biznesi, qeveria, shkollat etj. Ajo mbulon tre përcaktues të sjelljes në organizata: individët, grupet dhe strukturën bazuar në disa qasje themelore të sjelljes organizative. Sjellja organizative është një fushë e aplikuar ku zbatohen njohuritë e marra për individët dhe efekti i strukturës në sjellje, që organizatat të punojnë në mënyrë sa më efektive. Temat kryesore që do të trajtohen në këtë kurs janë në lidhje me motivimin, sjelljen dhe fuqinë e lidhshpimit, komunikimin ndërpersonal, struktura dhe procesi i grupit, procesi i të nxënës, zhvillimi dhe perceptimi i qëndrimit, procesi i ndryshimit, konflikti, dizajni i punës dhe stresi i punës					
Objektivat		Objektivi kryesor i këtij kursi është aftësimi i studentëve për analizimin e dukurive dhe problemeve që lidhen me sjelljen organizative të punonjësve në mjediset organizative është ndër objektivat e lëndës duke synuar përgatitjen e tyre si profesionistë në fushat përkatëse.					
Konceptet Kryesore		1. Personaliteti 2. Motivimi 3. Lidhshpimi 4. Cilësia dhe produktiviteti 5. Stresi dhe burnout 6. Marrëdhëniet ndërpersonale 7. Të nxënës 8. Konflikti 9. Komunikimi 10. Etika					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje në sjelljen organizative (Konceptet bazë dhe qasjet themelore): Cfare eshte organizata pse duhet studiuar sjellja e individit ne organizata, tiparet kryesore te oganizates, elementet psikologjike qe ndikojne në sjelljen organizative, perceptimi si element shume i rendesishem i sjelljes se njeriut dhe qe lidhet direkt me sjelljen organizative. Mimoza Kasimati 2010. Libri : " Sjellja ne Organizata". Botim Onufri Tirane (18-26) Cikël leksionesh: fq. 1-9						
2	Zhvillimi historik i sjelljes organizative dhe të nxënës në sjelljen organizative: Zhvillimi shkencor i sjelljes organizative, studimet e Frederik Taylor, Henry Fayol, Haëthorne Muntessberg dhe kontributi i tyre ne zhvillimin e fushës së menaxhimit. Si ndryshoi fokusi nga qenderizimi i punes tek rendesia e njeriut ne organizata. Modelet e sjelljes organizative. Cfare është procesi i të nxënës? Faktorët që ndikojnë tek të nxënës. Teoritë e sjelljes së kushtëzuar, teoria e të nxënës konjitiv si dhe teoria e të nxenit social dhe aplikimi i tyre. Mimoza Kasimati 2010. Libri : " Sjellja ne Organizata". Botim Onufri Tirane (52-71) Cikël leksionesh: fq. 9-16						
3	Personaliteti: Teoritë e personalitetit, faktoret qe ndikojne në zhvillimin e personalitetit si kultura gjenetika, arsimit etj. Karakteristikat e personalitetit dhe si lidhen ato me punën në organizatë? Tipet e personalitetit dhe roli i personalitetit në sjelljen organizative. Mimoza Kasimati 2010. Libri : " Sjellja ne Organizata". Botim Onufri Tirane (142-167) Cikël leksionesh: fq. 16-28						
4	Etika: Trajtimi i etikes ne sjelljen organizative. Kontributi qe ka ne permiresimin e marredhenieve dhe rezultatet e punës. Te drejtat morale, drejtësia dhe pergjegjesia shoqerore. Mimoza Kasimati 2010. Libri : "Sjellja ne Organizata". Botim Onufri Tirane (76-86)						

5	Diversiteti dhe Liderhipi: Percaktimi i diversitetit. Keshilla te rendesishme per menaxhimin e diversitetit. Si duhet menaxhuar diversitetin ne ditet e sotme në një shoqëri globale dhe multikulturore? Nivelet e diversitetit. Mimoza Kasimati 2010. Libri : "Sjellja ne organizata". Botim Onufri Tirane (92-109) Cikël leksionesh: fq. 55-64
6	Perceptimi: Kuptimi i perceptimit. Faktoret e jashtem te perceptimit. Faktoret e brendshem te perceptimit. Organizimi i perceptimit. Pse eshte i rendesishem procesi i perceptimit ne mjedisin organizativ? Perceptimi individual dhe kolektiv. Stereotipet dhe atribimet ne mjedisin organizativ pare nga kendveshtrimi i perceptimit. Mimoza Kasimati 2010. Libri : " Sjellja ne Organizata". Botim Onufri Tirane (116-134) Cikël leksionesh: fq. 29-33
7	Qendrimet: Cfare jane qendrimet? Si ndikojne ato ne vendimarrje dhe ne zbatimin e vendimeve te organizates. Nga burojne qendrimet dhe si mund te ndryshohen ato? Si ndikojne qendrimet ne kenaqesine ne pune dhe ne motivimin e individit? A jane qendrimet burim konfliktesh ne organizata? Mimoza Kasimati 2010. Libri : "Sjellja ne Organizata". Botim Onufri Tirane (176-192)
8	Kultura dhe Kultura organizative: Vlerat personale ne formimin e kultures. Kulturat dhe elementet e saj. Nenkulturat ne mjedisin e organizates. Formimi i kultures organizative. Ndikimi i kultures organizative ne rritjen e performances organizative. Ndryshimet kulturore dhe ndryshimet raciale mbi ato kulturore. Mimoza Kasimati 2010. Libri : "Sjellja ne Organizata". Botim Onufri Tirane (202-218) Cikël leksionesh: fq. 72-78
9	Grupi dhe skuadrat: Formimi dhe zhvillimi i grupit. Fazat e zhvillimi te grupit. Statusi dhe roli ne grupet organizative. Grupet formale dhe informale ne mjediset organizative. Skuadrat dhe disa lloje te skuadrave. Ndryshimi i grupit nga skuadra. Mimoza Kasimati 2010. Libri : "Sjellja ne organizata". Botim Onufri Tirane (226-261; 274-301) Cikël leksionesh: fq. 47-55
10	Motivimi: Motivimi dhe kuptimi i motivimit. Teorite e motivimit si ajo e hierarkise te nevojave nga Masloë, ajo e Herzberg te faktoreve te higjenes, teoria e motivimit sipas pritshmerise e Porter Laëler, e disa teori të tjera të motivimit. Rendesia e teorive te motivimit nga pikepamja e ndryshimeve dhe e pritshmerive ne mjediset organizative. Mimoza Kasimati 2010. Libri : "Sjellja ne Organizata". Botim Onufri Tirane (226-261)
11	Komunikimi: Rendesia e komunikimit. Faktoret ndërpersonalë ne komunikim. Mesazhet, kodimi, derguesi dhe marresi i mesazhit ne komunikim. Barrierat ne komunikim. Kanalet e komunikimit ne organizata. Llojet e komunikimit. Struktura organizative pare nga kendveshtrimi i komunikimit. Mimoza Kasimati 2010. Libri : " Sjellja ne Organizata". Botim Onufri Tirane (310-330) Cikël leksionesh: fq. 39-47
12	Konflikti dhe negociimi: Shkaqet e konfliktit. Faktoret e konfliktit. Faktoret strukturore te konfliktit. Faktoret personal te konfliktit. Fazat e zhvillimit te konfliktit. Llojet e konflikteve. Negocimi. Strategjite e negociimit. Ndërmjetësimi dhe teknikat e ndërmjetësimit. Pushteti dhe politika. Menaxhimi i pushtetit. Rendesia e pushtetit ne menaxhim. Mimoza Kasimati 2010. Libri : " Sjellja ne Organizata". Botim Onufri Tirane (336-353) Cikël leksionesh: fq. 64-72
13	Tregu i punes: Zhvillimi i profesioneve nder vite. Si kane evoluar disa profesione dhe si po shterojne disa profesione te tjera? Ndikimi i teknologjise ne tregun e punes.
14	Permbledhje, prezantime projekti
15	Provimi final
16	Final Exam
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • Mimoza Kasimati 2010. Libri : "Sjellja ne organizata". Botim Onufri Tirane	
Referenca të tjera • Mimoza Kasimati 2010. Libri : "Sjellja ne organizata". Botim Onufri Tirane	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të pajisen me njohuri bazë mbi sjelljen organizative Studentët do të jenë të aftë të njohin dhe përdorin sa më mirë burimet e informacionit mbi këtë fushë Studentët do të pajisen me njohuri mbi disiplina të ngjashme me fushën e sjelljes organizative Studentët do të jenë në gjendje të diskutojnë dhe të argumentojnë mbi çështje të ndryshme lidhur me sjelljen individuale në organizata

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	1	20	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	1	10	10
Gjysmë finale	1	14	14
Provimi final	1	20	20
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00